

URDHËR
Nr. 314, datë 28.5.2019

**PËR AUTORIZIMIN E NËNSHKRIMIT TË KËRKESAVE SOCIAL-JURIDIKE TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE**

Në mbështetje të nenit 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 134, datë 26.11.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit” dhe Kodit të Procedurave Administrative,

URDHËROJ:

1. Zëvendësimin e z. Armando Boçe, i ngarkuar me detyrë, drejtor i Drejtorisë së Evidencës Qendrore dhe Komunikimit me znj. Elsa Saka, me detyrë përgjegjës i Sektorit të Promovimit dhe Komunikimit, në Drejtorinë e Evidencës Qendrore dhe Komunikimit, e cila autorizohet të nënshkruajë kërkesat social-juridike të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

2. Specimeni i firmës së znj. Elsa Saka të dërgohet në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

3. Urdhri nr. 525, datë 30.10.2018 “Për autorizimin e nënshkrimit të kërkesave social-juridike të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido